**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E BRENDSHME**
Drejtoria e Pergjithshme e Policise
Departamenti per Kufirin dhe Migracionin
Drejtoria Rajonale per K&M Kukes

Nr. 706 Prot.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E FINANCAVE**
Drejtoria e Pergjithshme e Doganave
Dega e Doganes Morine Kukes

Nr. 511, date 04.11.2009

**URDHER**

**Per procedurat e perbashketa te Policise Kufitare dhe Migracionit dhe Sherbimit Doganor Shgipetar ne P.K.K.Morine, Q.Morine, Q.Prushi.**

Bazuar ne Ligjin Nr.9746 date 04.06.2007, "Per Policine e Shtetit", ne Ligjin Nr.8499, date 27.01.1999, "Kodi Doganor ne R.Sh", ne Ligjin Nr.9861, date 24.01.2008 "Per Kontrollin dhe Mbikqyrjen e Kufirit Shteteror". Ne rregulloren e perbashket te Ministrit te Brendshem Nr. 79616,, date 09.04.2008 dhe Ministrit te Financave Nr.487311, date 17.06.2008 "Per bashkepunimin ndermjet Sherbimit Doganor dhe Policit se Shtetit", me qellim rritjen e performances se dy sherbimeve dhe lehtesimin e procedurave ne hyrje/ dalje te shtetasve dhe mjeteve shqiptare dhe te huaja;

URDHEROJME

Ushtrimin e kontrolleve te perbashketa te Policise Kufitare dhe Migracionit dhe Sherbimit Doganor Shqipetar, per zbatimin ne praktike te parimit nje ndalese nje kontroll" ne Pikat e K.K Morine Kukes, Q.Prushi Has dhe Q.Morines Tropoje

**Uniforma**

Nuk lejohet ne asnje menyre qe te mos kene ose t'u mungoje perdorimi i shenjave dalluese qe vendosen ne menge si shiritat e krahut me mbishkrimin "Dogana Shqipetare"ne gjuhen Shqipe dhe Angleze te cilat duhen te dallohen lehte mbi funkioninldetyren e punonjesve qe merren me kontrollin.

Kontrolli spare perbehet nga dyfaza, kontrolli minimal dhe ai mesatar.

**1 Kontroll i lehte doganore: (kontrolli i vijes se 1-re)**

Marrja ne pyetje e udhetarit (qellimi, synimi dhe destinacioni i udhetimit, transporit i mallrave, dicka per te deklaruar), verejtja e reagimit dhe nje shikim i shpejte ne makine dhe ne bagazh po i shkarkuar bagazhet.

**2 Kontroll i mesem doganor me kerkim te imtesishem: (kontrolli i vijes se I-re)**

Doganieri duhet te informoje policine kufitare ne lidhje me kontrollet doganore te plaifikuara ne menyre qe t'i jape mundesine per te marre pjese ne kontroll dhe per te pasuar me shume siguri (veshtrimi i udhetarve)

Kontrolli doganor i mesem me kerkim te imtesishem eshte version i lehte me shkarkim dhe kontroll te bagazheve ne ane te korsise se trafikut praktikisht ne korsine e mesit. Ne kete rast motori duhet te fiket; udhetaret duhet te dalin nga makina dhe duhet ta shohin kontrollin duke endruar se bashku ne ane te makines. Gjate ketu lloji kontrolli pasaportat mbahen nga doganieri deri ne perfundim te kontrollit.
Kur doganieret kontrollojne bagazhet, ata duhet te mbajne doreza te vecanta per tu mbrojtur nga demtimet.

Kontroll doganor me kerkim te imtesishem (kontrolli i vijes se 2-te)

Procedura eshte e njejta si ne kontrollin doganor te mesem me kerkim te imtesishem, po zhvillohet ne sallen e kontrollit me masa shtese, te tilla si

- Perdorimi i pajisjeve te disponueshme
- Sjellja e qenve gjurmues/nuhates.
- Gjate kontrollit intensive, dyert e salles se kontrollit duhet te jene te mbyllura ne menyre qe te shmangen spektatoret dhe te parandalohet ventilimi i salles (qente gjurmues/nuhates)

**A. Per kontrollin e udhetareve**

Shtetasit shqiptare ose te huaj qe hyjne ose dalin ne ose nga Republika e Shqiperise perpunohen ne terminalin e pasagjereve dhe i nenshtrohen kontrollit kufitar/ doganor te njekohshem, per dokumentet e udhetimit, vizen e hyrjes (kur nevojitet), qellimin e udhetimit dhe kontrollin e bagazheve. Ushtrohet cdo lloj kontrolli ne baze te Analizes e Riskut, informacionit dhe perzgjedhjes:

**1. Kotrolli minimal i personave:**
Marrja ne pyetje e udhetarit (qellimi, synimi dhe destinacioni i udhetimit, transporiti i mallrave, dicka per te deklarua), veretejtja e reagimit dhe nje shkikim i shpejte ne makine dhe ne bagazh pa i shkarkuar bagazhet. Kur nje shtetsi shqiptar/ i huaj afrohet ne kabinen e kontrollit praqet dokumentin e udhetimit te vlefshem per te udhetuar.

Kontrolli i Policise Kufitare/ se bashku me punonjesin e doganes ben kontrollin e vijes se pare.
Kontrolli konsiston ne:
a)Keqyrjen e dokumentit te udhetimit per rregullat tij behet duke procedurat e brendshme te Policise Kufitare dhe Migracionit.
b)Punonjesi i Doganes ben kontrollin e bagazheve nese gjykohen per kontroll te tyre
c)Punonjsi i Policise Kufitare dhe Migracionit ben rregjistrimin e personit ne system
d)Shtetasve te huaj i behet verifikimi i shpejte i diteve te qendrimit (ne dalje)
e)Gjate regjistrimit ben kujdes per te lexuar alarmet jep sistemi.
f)Pas veprimeve te mesiperme vulos pasaporten dhe lejon shtetsin te hyje/ dale ne/ Republika e Shqiperise
g) Kur personi i paraqitur ne kabine rezulton se nuk permbush kushtet e daljes ose hyrjes, kontrollori shqiptar refuzon hyrjen/daljen nga Republika e Shqiperise duke bere evidentimin perkates ne system si dhe duke plotesuar formularin e parashikuar ne kete rast.

**2. Kontrolli i detajuar i personave:**

Kur gjate kontrollit minimal, kontrollori i P.K.M ose punonjesi i doganes gjykojne se kete person duhet ushtruar kontroll i detajuar kryejne veprimet e meposhtme:
a)Kontrollori i P.K.M njofton Pergjegjesin e Turnit dhe merr masa per sigurimin e tij, dergon pasaporten per ekzaminim te metejshem ne laborator. Pas verifikimit ne laborator vazhdohet procedura ne baze te rezultatit te verifikimit.
**b)** Kur nga sistemi jepet mesazhi per "person ne kerkim", kontrollori njofton Pergjegjesin e Turnit dhe vepron ne baze te urdherit te tij per sigurimin e personit
**c)** Kur gjate regjistrimit ne system del mesazhi per pasaporten "e pavlefshme", "e humbur, "jashte perdorimit" kontrollori njofton pergjegjesin e turnit dhe harton procesverbalin e bllokimit te pasaportes.
**d)** Kur gjate evidentimit te te dhenave ne hyrje/ dalje, shtetasit i refuzohet ajo, kontrollori i prapson, ben evidentimin ne system dhe perpilon procesvervalin e prapsimit/ refuzimit
e) Kur nga punonjesi i P.K.M ose i doganes kekohet qe personi te shkoje ne ambientetet e posacme per kontroll tedetajuar, duhet te kete prasysh gjinine e personit qe kontrollohet.
f)Kur udhetaret jane ne grup me autobus, ne baze te gjykimit, me informacion ose perzgjedhje, pasagjeret perpunohen ne terminal duke i kaluar nje e nga nje ne kontrollin e P.K.M dhe doganes. Pas perfundimit te kontrollit u jepet pasaporta lejohen te hipin ne autobus te vazhduar udhetimin.

## B. Per kontrollin e autoveturave

Automjetet shqiptare dhe te huaja qe hyjne/ dalin nga Republika e Shqiperise i neneshtrohen nje kontrolli minimal kontroli te detajuar dhe cdo lloj kontrolli tjeter ne baze te Analizes se Riskut, informacionit dhe perzgjedhjes. Kontrolli ushtrohet i njekohshem nga Policia Kufitare dhe migracionit dhe Dogana.'

**3. Kontroll te detajuar te autovetures:**
- Nese gjate kontrollit minimal ka dyshime, informacione riskut kryhet kontroll I detajuar. Grupi i perbashket kryen keto veprime:
a) I kerkojne drejtuesit te mjetit te drejtoje makinen ne ambientin e Ures se Kontrollit te Mjeteve duke u shoqeruar nga nje punonjes policie
b) Bejne kontrollin e detajuar te mjetit duke perdorur pajisjen e dhena ne perdorim.
c) Ne kontrollin e detajuar perdoret qeniantidroge dhe mjetet e tjera ne perdorim te te dyja agjensive.
d) Ne perfundim te kontrollit hartojne aktet proceduriale ne baze te rezultatit te kontrollit
e) Evidentojne ne rregjister kontrollin e bere.
•Kur gjate kontrollit evidentohen mallrat e ndaluara, lende narkotike, toksike dhe psikotrope, veprimet kryhen ne baze te Kodit te Procedures Penale ose te Kodit Doganor.

## C. Per kontrollin e autobuseve.

Autobuset shqiptare dhe e huaj qe hyjne/dalin nga Republika e Shqiperise i neneshtrohen nje kontrolli minimal, kontrolli te detajuar dhe cdo lloj kontrolli tjeter ne baze te Analizes se Riskut, informacionit dhe perzgjedhjes. Kontrolli ushtrohet i njekohshem nga Policia Kufitare dhe Migracionit dhe Dogana. Pasi kontollohen pasagjeret nga Policia Kufitare dhe Migracionit per dokumentet e udhetimi, vizen e hyrjes (kur nevojitet dhe qellimin e udhetimit, Sherbimi doganore kontrollon bagazhet e mjetit.Gjithashtu ushtrohet do lloj kontrolli tjeter ne baze te Analizes se Riskut, informacionit dhe perzgjedhjes:

**1. Kontrolli i vijes se pare:**
Punonjesi i P.K.M-se mbledh pasaportat duke bere numerimin e tyre dhe pasagjereve duke bere krahasimin e listes se udhetareve, dokumentit te udhetimit dhe personave dhe intervistimin ne lidhje me qellimin e udhetimit etj. Punonjsi i doganes ben kontrollin dhe/ ose rregjistrimin e dokumentacionit te mjetit per llogari te doganes. Nersa kryhet rregjistrimi i te dhenave te

udhetareve dhe mjetit ne system, punonjesi i doganes dhe i P.K.M-se bejne kontrollin minimal ose mesatar te mjetit si kunder ne kontrollin e autoveturave.

**2. Kontrolli i detajuar:**

Behet ne ambientin e posacem te ngritur per kontroll.
a) Drejtuesi i mjetit qendron bashke me mjetin ndersa pasagjeret qendrojne ne terminal.
b) Grupi qe ben kontrollin e detajuar perbehet nga nje punonjes i PKM dhe nje i doganes
c) Ne kontrollin e detajuar perdoret dhe qeni antidroge clhe mjetet e tjera ne perdorim tete dyja agjensive.
d) Ne perfundim te kontrollit hartohen aktet proceduriale ne baze te rezultatit tekontrollit.
e) Evidentojne ne rregjister kontrollin e bere.

•Kur gjate kontrollit evidentohen mallrat e ndaluara, lende narkotike, toksike dhe psikotrope,veprimet kryhen ne baze te Kodit te Procedures Penale ose te Kodit Doganor.

**D. Per kontrollin e Kamionave.**

Kamionat shqiptare dhe te huaj qe hyjne/dalin nga Republika e Shqiperise i nenshtrohen nje kontrolli minimal, kontrolli e detajuar dhe cdo lloj kontrolli tjeter ne baze te Analizes se Riskut, informacionit dhe perzgjedhjes. Kontrolli ushtrohet i njekohshem nga Policia Kufitare dhe Migracionit dhe Dogana. Gjithashtu ushtrohet cdo lloj kontrolli tjeter ne baze te Analizes se Riskut, informacionitdhe perzgjedhjes

**1. Kontrolli i v ijes se pare:**
Behet ne ambientin e posacem te ngritur per kontroll.
a)Kontrollohet dokumentacioni i drejtuesve dhe mjetit nga PKM dhe Dogana sipas drejtimit te punes.
b)Behet kontrolli i siperfaqshem i mjetit per te evidentuar demtime te mbuleses se mjetit ose fijes se plumbosur.
c)Kur cdo gje rezulton ne rregull lejohet qe mjeti te vazhdoje udhetimin.

**2. Kontrolli i detajuar:**
Behet ne ambientin e posacen te ngritur per kontroll.
a)Drejtuesi i mjetit bashke me mjetin dergohet ne kontrollin e detajuar ndersa shoqeruesit (nese ka) mjeti qendrojne ne terminal.
b)Grupi qe ben kontrollin e detajuar perbehet nga nje punonjes policie i P.K.M dhe nje punonjes i doganes
c)Ne kontrollin e detajuar perdoret edhe qeniantidroge dhe mjetet e tjera ne perdorim te te dyja agjensive.
d)Ne perfundim te kontrollit hartohen aktet proceduriale ne baze te rezultatit te kontrollit.
e)Evidentohen ne rregjister kontrolli i bere.
f) Kur gjate kontrollit evidentohen mallrat e ndaluara, lende narkotike, toksike dhe psikotrope, pas informimit te drejtuesve reciprok te doganes dhe policies veprimet kryhen ne baze te Kodit te Procedures Penal e ose te Kodit Doganor.

•Gjate kontrolleve te vijes se pare per te gjitha llojet e mjeteve eshte i detyrueshem perdorimi i mjeteve ndihmese si, pasqyra, drita ultravjollce etj
•Gjate kontrollit qe ushtrohet ne formen e interpolit per mjetet e vjedhura mjeti dhe udhetaret qendrojne ne korsi te vecante dhe gjate procedurave.te tjera hetimore qytetari nuk duhet te gjendet present.

Keto detyra jane te detyrueshme per t'u zbatuar nga punonjesit e te dy agjensive te zbatimit te ligjit te cilat operojne ne Pikat e K.K. Morine Kukes, Q.Morine Tropoje dhe Q.Prushi Has

E. Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

| | |
|---|---|
| **Drejtori I D.R.K.M Kukes** | **K/Deges Doganes Morine Kukes** |
| **Ylber ZYBERI** | **Gjovalin PROGNI** |